



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
Komisioni Apelitimit Studentor

V E N D I M

Nr. 7 Datë 23.12.2021

*“Për trajtimin e ankimit se znj.Reisa Kalanxhi”*

Bazuar në nenin 8, pika 3, të Rregullores “Për zgjedhjet e para të këshillave të studentëve në Universitetin e Tiranës”, miratuar me Vendimin nr. 22, datë 26.06.2019 të Senatit Akademik të UT-së, Komisioni Apelitimit Studentor ka marre ne shqyrtim ankesen e drejtuar nga znj. Reisa Kalanxhi me objekt:

- “ 1.Pavlefshmerine e zgjedhjeve ne Fakultetin e Drejtesise per te gjitha vitet.*
- 2. Sigurimin e provave dhe materialeve te nevojshme per pretendimet e ngritura”*

Ankuesja Reisa Kalanxhi ka argumentuar gjate seances se zhvilluar se: “Ka pasur nje shkelje te nenit 12, pika 6 pasi lista e afishuar ne Fakultetin e Drejtesise dhe lista e derguar nga ana e KIZS kane formate te ndryshme, ne listen e afishuar ne fakultet jane vetem nr. Personal te Identitetit ndersa ne listen e derguar nga KIZS jane emer, mbiemer dhe nr. Personal i identitetit, me tej ankuesja ngre pretendimin se eshte shkelur neni 22, pika 2, germa “c”, i cili ka te bej me nenshkrimin ne ane te listes nga ana e votuesit ne momentin qe paraqitet perpara KQV. Pretendimi i trete ka te bej me mungesen e fleteve te votimit ne Fakultetin e Drejtesise, ku pretendohet se ka pasur mungese dhe ka pasur votues qe jane larguar pasi nuk kane mundur te votojne per shkak te mungeses se fleteve te votimit.

Gjate seances se zhvilluar Komisioni Apelitimit Studentor fillimisht ka argumentuar se Ankuesja Reisa Kalanxhi mund te kerkoj pavlefshmeri te zgjedhjeve vetem per vitin ne te cilin ajo kandidon pasi eshte kandidat e legjitimuar vetem per kete vit dhe interesi i saj i ligjshem lidhet me vitin ne te cilin ajo kandidon, me pas persa i perket:



1. Pretendimit te pare lidhur me nenin 12 pika 6, listat e afishuar nga Sekretaria e Fakultetit dhe lista e derguar nga ana e KIZS, pavaresisht se nuk jane nje kopje identike e njera tjetres, jane ne perputhje te plote me njera tjetren pasi jane derguar nga ana e KIZS te dy keto lista me te cilat eshte pajisur KQV dhe se ne momentin kur personi votonte verifikohej ne te dy listat pasi numrat rendor te te dyja listave perkonin me njeri tjetrin dhe ne njerin liste ishte emer mbiemer, nr personal dhe ne listen e Sekretarise ne te njejtin numer rendor ishte nr. Personal i identitetit te po atij personi.

2. Pretendimit te dyte lidhur me nenin 22, pika 2 germa c, nje shkelje e tille nuk eshte konstatuar nga ana e KZSF dhe kandidatja gjithashtu gjate procesit te votimit ka pasur vezhgues te saj ne QV perkatese ne te cilen ajo ka qene candidate.

3. Pretendimit te trete lidhur me mungesen e fleteve te votimit, KAS ka argumentuar se ne Fakultetin e Drejtesise eshte e vertet se ne fillim te procesit numri i fleteve te votimit nuk ka qene i plote per shkak te problematikave teknike nga ana e KIZS por per asnje moment nuk kane munguar flete votimi ne asnje prej KQV-ve duke mos e cenuar keshtu procesin dhe duke mos lejuar asnje votues qe t'i pengoj e drejta per te votuar.





4. Ne asnje nga pretendimet e ngritura nuk kemi nje cenim te tille qe te jemi ne kushtet e Nenit 28 i cili kerkon qe cenimi i procesit te jete ne nje mase te tille qe te kete ndikuar ne fitimin e mandatit.

Per sa me siper, Komisioni Apelimt Studentor:

### VENDOSI:

1. Rrezimin e plote te ankimit.
2. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Per kete vendim votuan:

1. Rubin Rredhi (Kryetar) (Votoj abstenim) 
2. Adelina Yzeiri (Anetare) 
3. Katerina Hoxha (Anetare) 
4. Enxhi Bibo (Anetare) 
5. Sindi Myrtaj (Anetare) 